



diasporaflet.org

VIRTUALE *Konferenca*
DIASPORA FLET

19-21 Nëntor 2020



GLOB—
AL2020

Rreth ngjarjes

Diaspora Flet 2020 - konferenca kryesore globale e Diasporës Shqiptare - do të mbahet virtualisht me 19-21 nëntor 2020. Konferenca synon të lidhë profesionistë të industrisë, biznese, komunitete, aktivistë dhe ekspertë nga e gjithë bota për të reflektuar mbi angazhimin e diasporës shqiptare në 20 vitet e fundit dhe për të eksploruar dhe reflektuar mbi rolin e saj në 20 vitet e ardhshme.

Konferenca është **organizuar nga GERMIN** - një organizatë lidere jofitimprurëse e specializuar në Angazhimin e Diasporës Shqiptare, në partneritet me organizatën e saj motër me qendër në ShBA, **Global Albanians Foundation**.

Konferenca e këtij viti është thurur rreth temës "GlobAL2020: Lidhu. Krijo. Bashkëpunohet" që synon të eksplorojë mënyra në të cilat shqiptarët në të gjithë botën mund të ndikojnë pozitivisht dhe forcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, të kontribuojnë në rritjen e komuniteteve të diasporës dhe të bëjnë ndryshime domethënëse në jetën e atyre që jetojnë në vendet e origjinës.



Avokim & Diplomaci

Dita e parë do t'i kushtohet diskutimeve dhe fjalimeve në lidhje me Angazhimin e Diasporës nga perspektiva e avokimit, diplomacisë dhe mënyrave se si ne kemi bashkë-krijuar me komunitetet tona përreth globit. Përmes një folësi kryesor, diskutimeve interaktive dhe paneleve, synojmë të rimendojmë të ardhmen e përbashkët.



Biznes & Investime

Dita e dytë është e organizuar rreth temave të Angazhimit Ekonomik të Diasporës - Ndërtimi i besimit për të investuar në atdhe; Vendorsja e diasporës si pikë hyrëse për lidhjet e tregut dhe promovim të eksportit; Teknologjia, Inovacioni dhe Outsourcing si dhe Filantropia do të trajtohen gjithashtu gjatë kësaj dite.



Kapitali Njerëzor & Edukimi


Dita e tretë do të hedh dritë mbi transferin e njohurive dhe aftësive nga diaspora në atdhe. Cilat lloje të programeve të migrimit qarkor duhet të ndërtohen për të mundësimin e kthimit afatshkurtër ose afatgjatë në vendet e origjinës? Si mundet diaspora profesionale dhe shkencore të kontribuojë në krijimin e një force pune të aftë dhe prodhimin e dijes në vendet amë.

Çfarë mund të prisni?



Ngjarja Kryesore - Skena Kryesore

Anëtarët e njohur të Diasporës do të hapin konferencën. Çdo ditë do të ketë një folës kryesor për të folur në një format të sesionit të pyetjeve dhe përgjigjeve për temat kryesore.



Sesionet e Partnerëve për Zhvillim Ndërkombëtar

Organizatrat ndërkombëtare paraqesin objektivat e tyre strategjike në panele / punëtori / ekspozita të veçanta.

Panairi Virtual

Bizneset lokale dhe ato të diasporës shfaqin produktet dhe shërbimet e tyre



Breakout / Seancat Paralele

Organizuar dhe mirëpritur nga palët e interesit dhe partnerët. Këto sesione do të jenë interaktive, duke angazhuar pjesëmarrësit në tema specifike.



Angazhimi Qeveritar / Institucional

Sesione të targetuara ku anëtarët e diasporës angazhohen dhe diskutojnë drejtpërdrejt me zyrtarë publikë për tema me interes.

Ankand dhe Raffles

Dhurimi i produkteve në ankandin virtual për të ndihmuar mbledhjen e fondeve për kauzat tona



Bisedat / Tregimet Inspiruese

Anëtarët e Diasporës dhe qytetarët e vendeve tona të atdheut paraqesin ide dhe projekte inovative, si dhe histori frymëzuese në një format të shkurtër të videos 5-10 minutëshe.



Rrjetëzimi dhe Mundësitë e Tregut

Hapësira virtuale për Rrjetizim Profesional, HeadHunting dhe Shkëmbime; Takimet e Bizneseve me Biznese (B2B) dhe Bizneseve me Klientët (B2C) gjatë 3 ditëve të konferencës.

Ceremonia Mbylljes

Performancë Artistike Transmetuar Direkt nga Sheshi Kryesor i Prishtinës

Nëntor 2020

M	T	W	T	F	S	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

Datat dhe Orari i Konferencës

Konferenca *Diaspora Flet 2020* do të zhvillohet në tre ditë, 19, 20, 21 nëntor, duke mbuluar zona të shumta kohore. Arsyeja pse ne kemi zgjedhur këto data është sepse ato i paraprijnë ditës së Flamurit Kombëtar dhe qëllimi ynë është që kjo konferencë të shërbejë si një moment reflektimi për shqiptarët në mbarë botën para një date historike. Çdo ditë është e ndarë në dy seanca kryesore, me një ngjarje kryesore, seanca paralele dhe pauzë në mes.

14:00 - 16:00

Central European Summer Time (CEST) UTC +02:00

08:00 - 10:00

Eastern Standard Time (EST) UTC -04:00

18:00 - 20:00

Central European Summer Time (CEST) UTC +02:00

12:00 - 14:00


Eastern Standard Time (EST) UTC -04:00

Duke vazhduar nga *Diaspora Flet 2018*

Konferenca Diaspora Flet është ‘thirrëse’ e fuqishme për angazhimin e diasporës, e cila mbahet çdo dy vjet. Diaspora Flet 2020 mbështetet në suksesin e Diaspora Flet 2018, një konferencë ndërkombëtare mbi diasporën që bashkoi ligjvënës, zyrtarë qeveritarë dhe një grup të larmishëm me mbi 300 profesionistë shqiptarë, studiues, drejtues të komunitetit dhe përfaqësues të biznesit nga 24 vende.

Diaspora Flet 2018 ka rezultuar në krijimin e një rrjeti prej 150 profesionistësh nga 7 sektorë të ndryshëm të cilët kanë kontribuar drejtpërdrejt në hartimin dhe përmirësimin e politikave në Kosovë dhe zhvillimin e kauzave në sektorë të ndryshëm (p.sh. legjislacionin për të drejtën e përfaqësimit / votës, politikat energjetike dhe mjedisore, politika sociale, ndërmarrjet shoqërore dhe filantropia).

PLAY
PROMO
VIDEO



Rrugëtimi ynë

Kur filloi GERMIN, identiteti ynë ishte në përputhje me zhvillimin e komunitetit dhe angazhimin e diasporës. GERMIN u krijua si një organizatë joqeveritare, parimet dhe idealet thelbësore të së cilës bazoheshin në besimin se diaspora shqiptare duhet të luajë një rol të gjerë dhe proaktiv në zhvillimin pozitiv të të gjitha vendeve në Ballkan ku jetojnë shqiptarët. Ne jemi rritur përtej kësaj tani dhe e gjejmë veten duke punuar në shumë fusha të tjera si inovacioni shoqëror, ndikimi / përfaqësimi politik, lidhjet e tregut, biznesi me biznesin (B2B), biznesi me konsumatorin (B2C) dhe filantropia.

Ne kemi punuar dhe lansuar KosovoDiaspora.org që në vitin 2012, dhe për dy vjet kemi punuar si një grup joformal, duke promovuar Kosovën në botën dixhitale. Pas hartimit të 750 profileve të profesionistëve të diasporës, kemi kuptuar fuqinë e diasporës dhe nevojën për të promovuar një komunikim të dyanshëm si pjesë e një procesi të bashkë-krijimit.





Fjala Germin rrjedh nga gjuha latine, *Germinare*, qe do të thotë “të fillojë të rritet,” ose “të zhvillohet nga fara në lule,” ose “të ngritet lartë.” Inspirimi për këtë emër vjen nga novela e shkrimtarit francez të shekullit XIX, *Emile Zola*, të quajtur *Germinal*. Kështu edhe organizata jonë e sheh qëllimin e punës dhe aktiviteteve si një mbjellje e farave, të korrat e të cilave do të sherbejnë në rrugëtimin e shoqërisë sonë drejt zhvillimit.

Rreth Nesh

Germin është një organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet virtuale për të lidhur dhe angazhuar Diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre. Ne përpiqemi të eksplorojmë dhe sjellim kanale alternative për të lehtësuar dhe forcuar lidhjet midis diasporës, qytetarëve dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor.

Germin drejtohet nga një grup profesionistësh të Diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informacionit dhe teknologjisë, ligjit dhe arsimit, sigurisë dhe mbrojtjes, energjisë dhe ambientit. Germin ka një rrjet profesionistësh dhe bashkëpunëtorësh, që aktualisht jetojnë në 24 vende përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut. Germin gjithashtu ka një rrjet prej 250+ organizatash partnere në Diasporë, me bazë në Evropë, Shtetet e Bashkuara, Kanada, Azi dhe Australi.

● Adresa

Tringe Smajli 48
10000 Prishtina,
Republic of Kosovo

● Uebfaqja / E-maili

www.germin.org
info@germin.org
diasporaflet2020@germin.org

● Na ndiqni:

